

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i Prokurimit : **KEK - 26 - 146 - 121**

Nri brendshem : **KEKC - 26 - 010 - 121**

Sa i përket tenderit për : **Furnizim me pjesë rezervë për xhuntat hidrodinamike për sistem të thëngjillit B1,B2**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

UNIVERS – M SH.P.K.

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

Rruga Eqrem Qabej pn

Adresa

Millosevë – KK Obiliq

15050

Vendi/Kodi postar

044 276 071

(Numri Telefonit) Numri i Faks-it

TEFIK HARGAJA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

e-mail: univers.m.pr@gmail.com

Adresa elektronike

Dt.07.08.2026

Data e parashtrimit të ankesës Nënshkrimi dhe vula



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

- Njoftimi për kontratë datë 23.01.2026
- Afati i fundit i dorëzimit të tenderit datë 16.02.2026
- Kriteri i dhenjes së tenderit: **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët** ☒

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Eshtë organizuar hapja publike e ofertave në sistemin e E-prokurimit
Hapja e ofertave nëmenyre elektronike është bërë me dt.16.02.2026, nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 31.07.2025 përmes platformës së e – Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues – Korporata energjetike e Kosovës sh.a.

Me datë 03.08.2026 përmes platformës së e – Prokurimit kemi pranuar Përgjigjen – Vendimin nga Autotoriteti Kontraktues që Kërkesën tonë për Rishqyrtim e konsideron si të pa bazuar.

Të pa kënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues në afatin ligjorë e dërgojmë Ankesën në OSHP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, me rastin e publikimit të njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes e – prokurimit të pranuar me datës **28.07.2026 për dhënie të kontratës – shperblim me kontratë** për këto aktivitetet të prokurimit **Furnizim me pjesë rezervë për xhontat hidrodinamike për sistem të thëngjillit B1,B2** ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Është shkelur neni 1 i LPP-se,
- Është shkelur neni 7 i LPP-se,
- Është shkelur neni 28 i LPP-se,
- Është shkelur neni 29 i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 56(1-2) i LPP-se
- Eshte shkelur neni 59 i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 60.1(1.1) i LPP-se,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtartifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania Univers – M shpk në Kërkesën për Ri-shqyrtim do të prezentojë faktet përmbajtësore për të argumentuar shkeljet ligjore të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me dt.28.07.2026 dërgon Njoftimin mbi Vendim e AK për dhënje të kontratës publike në portalin e – prokurimit

Nëpërmjet këtij vendimi AK shpërblen me kontratë : ARI BUSINESS PARTNERS SHPK

OE UNIVERS – M SH.P.K me dt.28.07.2026 ka dërguar në AK Kërkesën për qasje në dokumente , qasja nga ana e AK na është mundësuar me dt.29.07.2026

Për të njëjtin aktivitet të prokurimit kemi edhe Vendimin e **OSHP-së nr 2026/0233 dt.13.05.2026** dhe Ankesa e OE UNIVERS – M SH.P.K. **Aprovohet** si e bazuar dhe lënda kthehet në rivlersim.

Dhe pasë marrjes së dokumentacionit në këtë aktivitet të prokurimit kemi konstatuar që OE ARI BUSINESS PARTNERS SH.P.K. i cili është shpërblyer me kontratë nga komisioni i rivlersimit të AK nuk ka qenë ofertues i përgjegjshëm për këto arsye:

Në dosjen e tenderit , në përshkrimin e çmimit , në ANEKSIN 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME dhe ne vizatimin e AK të bashkangjitur specifikimit teknik është kërkuar:

- Poz.1: Xhunta hidrodinamike tip Eg 750 , **d1=85 m6** , d2=110 H7 dimensionet tjera sipas tab. 1.1
- Poz.2: Xhunta hidrodinamike tip Eg 320 , **d1=38 m6** , d2=50 H7 dimensionet tjera sipas tab. 1.1

Poz.1: Xhunta hidrodinamike tip Eg 750 , fusha e tolerances e kërkuar sipas dosjes së tenderit në **Aneksin 1 Specifikimet teknik të detyrueshem , në përshkrimin e çmimit, dhe në vizatimin e publikuar në dosjen e tenderit të AK , është kërkuar që fusha e tolerances me qenë për : d1=85 m6** , kurse ne vizatimi teknik pn të Prodhuesit :*Hangzhou Ever-Power Transmission Co Ltd*), i dorëzuar në ofertë me dt.16.02.2026 e specifikon qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me fushën e tolerancës per d=1 Ø85 H7 në kundërshtim me specifikimin teknik të detyrueshem dhe kerkesat ne DT

Poz.2 Xhunta hidrodinamike tip Eg 320 , fusha e tolerances e kërkuar sipas dosjes se tenderit ne **Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme , në përshkrimin e çmimit, dhe ne vizatimin e publikuar ne dosjen e tenderit të AK , është kërkuar qe fusha e tolerances me qenë për : d1=38 m6** , kurse ne vizatimi teknik pn të Prodhuesit :*Hangzhou Ever-Power Transmission Co Ltd*), i dorëzuar në ofertë me dt.16.02.2026 e specifikon qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me fushën e tolerancës per d=1 Ø38 H7 në kundërshtim me specifikimin teknik te detyrueshem dhe kerkesat në DT.

Ne oferten e OE të shperblyer me kontratë , në vizatimin e prodhuesit për poz.2 :Xhunta hidrodinamike tip Eg 320 dimenzionet tjera sipas tab. 1.1 prodhuesi per dimenzionin **ØB** ka ofertuar me dimenzion **220mm** , kurse sipas **Aneksit 1 Specifikimet teknike te detyrueshme** te dosjes se tenderit dimenzioni **ØB** është këkuar me qenë : **226mm**

Gjate fazes së rivlersimit të ofertave AK me dt.**06.07.2026** ka dërguar Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë : **Letren standarde për sqarimin e tenderit ku ceket:**

Meqenëse nga vizatimi teknik i publikuar nuk mund te identifikohet qartë diametri dhe fusha e tolerances per d1 , ju lutemi te na ofroni sqarimin perkates

Konkretisht , ju lutemi te konfirmoni se cili diameter dhe fushë tolerance duhet te zbatohet gjate prodhimit te xhutes :

d1=m6 ose

d1=H7

Nga kjo vertetohet që komisioni i rivlersimit nga AK , kërkon nga OE i rekomanduar për kontratë sqarimin e tenderit dhe vizatimin e publikuar në dosjen e tenderit që janë të publikuara nga **vet AK** sepse dosja e tenderit është publikuar nga AK .

Edhe pse në **Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme dhe vizatimin e AK** te publikuar ne dosjen e tenderit **shihen shumë qartë dhe janë të indentifikueshme fushat e tolerances per d1 për të dy llojet – tipet e xhuntave hidrodinamike tipi Eg 750 dhe tipi Eg 320.**

(bashkangjitur dëshmin **nr.1** ku **shihen shumë qartë dhe janë të indentifikueshme fushat e tolerances për d1=m6** për dy tipet e xhuntave hidrodinamike nga dosja e tenderit)

Me dt.08.07.2026 OE i rekomanduar për kontratë e bënë sqarimin e tenderit ku sqaron: Përmes kësaj deklarate konfirmojmë se xhuntat do të prodhohen sipas specifikimeve teknike të detyrueshme tek Aneksi 1

Konfirmojmë se diametrat dhe fushat e tolerances do te jenë për dy xhuntat hidrodinamike si vijon:

1. Për xhunten hidrodinamike tip Eg 75 d1=Ø85 m6 , d2=110H7
2. Për xhunten hidrodinamike tip Eg 75 d1=Ø38 m6 , d2=50H7

Pra konfirmojme se diametri dhe fusha e tolerances gjatë prodhimit do të zbatohet d1=m6

Këtu ka një gabim nga OE i rekomanduar për kontratë sepse në dy pozicionet(për poz.1 dhe për poz.2) e ka cekur në sqarim xhunta hidrodinamike tip **Eg 75** , kurse ne DT(dosjen e tenderit) poz. 1 është xhunta hidrodinamike **tip Eg 750** kurse poz.2 xhunta hidrodinamike **tip Eg 320**

Siq shihet OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar në ofertë të dt.16.02.2026 vizatimet e vërtetuara nga vet prodhuesi për pozicionin nr.1 xhunten hidrodinamike tip Eg 750 me fushe tolerance **d1=85 H7** , dhe vizatimet e vërtetuara nga vet prodhuesi per pozicionin nr.2 xhunten hidrodinamike tip Eg 320 me fushe tolerance **d1=38 H7**

(bashkangjitur dëshmin **nr.2** vizatimet e vertetuara nga vet prodhuesi ku **shihet qartë** dhe janë të identifikueshme fushë e tolerancat për janë dimenzionin **d1=H7** për dy tipet e xhuntave hidrodinamike.)

Kurse OE i rekomanduar për kontratë në sqarim të tenderit të dt.08.07.2026 ka deklaruar se poz.1 xhunta hidrodinamike tip Eg 75 fushen e tolerancës do të ketë **d1=85 m6**, dhe poz.2 xhunta hidrodinamike tip Eg 75 fushen e tolerancës do të ketë **d1=38 m6**

Këto dy dokumente të OE të rekomanduar për kontratë janë në kontradiktë të plot me njëra tjetrën dhe përbëjnë **devijim material nga dosja e tenderit** dhe dëshmojnë shkelje të paster teknike sepse në vizatimet teknike të prodhuesit të vertetuara nga vet prodhuesi për fushe tolerancën **d1** ka ofertuar me fushe tolerancë **H7**, kurse në sqarim ka thënë **d1=m6** kjo sipas Ligjit të Prokurimit publik në Kosovë ky përben **ndryshim të ofertes ose devijim material** gjë që duhet të çonte në eliminim e jo të shpallet fitues,

Dhe po ashtu duke përcaktuar se fushë tolerancat janë baza kryesore e specifikimit teknik sepse në përpilimin e specifikimit teknik nga AK është kërkuar toleranca **për d1=m6 dhe tolerancë d2=H7** dhe dimenzionet tjera sipas tabelës 1.1 sepse baza dhe faktorë kryesor teknik për montimin e këtyre xhuntave hidrodinamike me pajisjet tjera, dhe funksionimin stabil të tyre në ngarkesa të mëdha në sistemin e transportimit të thëngjillit pa vibrime në procesin e prodhimit janë toleranca e dimenzionit **d1=m6**.

Dhe ky veprim **nuk** përbën sqarim por përbën **ndryshim të ofertes teknike pas hapjes së tenderit gjë që ndalohet rreptësisht me LPP**.

Këto fushe toleranca janë sqaruar edhe nga **Raporti Ekspertit Shqyrtues nr. 2026/0233 dt.29.04.2026** ku eksperti Teknik e ka përshkruar në detaje dallimet e fushë tolerancat në mes të **d1=H7** dhe fushë tolerancës **d1=m6**, ku në ekspertizë është cekur se montimi i xhuntës me tolerancë **d1=H7 nuk** është i mjaftueshëm për të eliminuar vibrimet dhe dëmtimet e pjesëve tjera të boshtit, **andaj është kërkuar që tolerancë me qenë d1=m6** që siguron që qendra e boshtit dhe qendra e xhuntës të jenë absolutisht të njëjta, duke reduktuar dridhjet në mënyrë që të mos dëmtohen pjesët tjera.

Duam të potencojmë se Xhunta hidrodinamike tipi Eg 750 ka ngarkesë të madhe në prodhim dhe montohet në Reduktorin i cili e terheq shiritin të ngarkuar me thëngjill me kapacitet të plotë, dhe pjerrtësi shumë të madhe në terheqjen e thëngjillit, Reduktori e ka fuqinë e madhe **P=660 kW** dhe boshti hyrës i këtij reduktori ku montohet xhunta hidrodinamike e ka fushë tolerancën **d1=85 m6** dhe Reduktori ka numër të madh të rrotullimeve dhe numri rrotullimeve në bosht është **n1=1480 rr/min**, dhe për këtë arsye në Aneksin 1 Specifikimin teknik të detyrueshëm është kërkuar tolerancë me qenë **d1=m6** sepse është **kërkesë specifike** dhe është baza dhe faktori kryesor për funksionimin stabil pa vibrime të këtyre pjesëve në procesin e prodhimit.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Nenin 59(Ekzaminimi, Vlerësimi, dhe Krahësimi i Tenderëve dhe Nenin 56 (Sqarimi i Tenderëve) të LPP** duke shpallur të **pergjegjshëm tenderin që ka devijime materiale**.

Ndryshimi i ofertes pas hapjes (Neni 56.2 i LPP-së): Ligji specifikon se asnjë ndryshim në substancën e tenderit **nuk** mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet, sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar produkte me vizatime të vertetuara nga vete prodhuesi me fushe tolerancë **H7**, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë premton

dorezim te produktit me fushe tolerance **m6** , kjo dëshmon se oferta eshte nga fillimi e **papergjegjshme**.

AK – KEK-u ka pasur për obligim ligjor që ta eliminojë këtë oferte si jo konform kërkesave teknike gjegjesisht Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme , sepse vizatimet e vertetuar dhe nenshkruar nga vet prodhuesi dhe te dorezuar ne oferte **nuk** mund te korrigjohet apo te ndryshohet permes një deklarimi te thjesht me shkrim nga Operatori Ekonomik.

AK me dt.**03.08.2026** me nr.protokoli **5576** permes platformes e-prokurimi kemi pranuar Vendimin ku Kerkesen toë per Rishqyrtim e Refuzon si të pa bazuar.

Pergjigja e OE Ankues nr.1 ne Kerkesen per Rishqyrtim:

Komisioni i Rivlersimit gjate ekzaminimit te dokumentacionit teknik te ofertes ka konstatuar se nga vizatimet teknike te dorezuara nuk mund te identifikohen ne menyre te qarte fusha e tolerances per dimensionet **d1** perkatesisht nese gjate prodhimit do te zbatohet tolerance **m6** apo **H7**

Komisioni Rivlersimit kur ka kerkuar sqarimin në:**Letren standarde për sqarimin me tenderit e dt.06.07.2026 e ka cekur:**

Meqenëse nga vizatimi teknik i publikuar nuk mund te identifikohet qartë diametri dhe fusha e tolerances per **d1** , ju lutemi te na ofroni sqarimin perkates

Konkretisht , ju lutemi te konfirmoni se cili diameter dhe fushë tolerance duhet te zbatohet gjate prodhimit te xhutes :

d1=m6 ose

d1=H7

Komisioni i Rivlersimit kur ka kërkuar sqarimin e tenderit nga OE i rekomanduar per kontrate ka thene se vizatimi i publikuar nuk mund te identifikohet qartë diametri i tolerances per **d1** (këto dokumente janë të publikuara nga vet AK dhe komisioni i rivlersimit kerkon sqarimin e tenderit nga OE i rekomanduar per kontrate per dokumentacionin e publikuar nga vet AK)

(Bashkangjitur dëshmin nr.3: Letren standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit dt.06.07.2026)

Kurse ne pergjigjen ne Vendimin e dt.**03.08.2026** ne Kerkesen per Rishqyrtim ,i njejt komision i Rivleresimit thotë se kemi konstatuar se vizatimet teknike te dorezuara nuk mund te identifikohen ne menyre te qarte fusha e tolerances per dimensionin **d1**

Ky konstatim i komisionit te rivlersimit **nuk** qëndron sepse edhe me rastin e publikimit te dosjes se tenderit gjegjesisht Aneksi 1 Specifikimi Teknik i detyrueshem , dhe vizatimi i publikuar nga AK shihen shumë qartë dhe janë të identifikueshme fusha e tolerances **d1=m6**

(bashkangjitur dëshmin nr.1 ku shihen shumë qartë dhe janë të indentifikueshme fushat e tolerances për **d1=m6** për dy tipet e xhuntave hidrodinamike nga dosja e tenderit)

Edhe ne rastin kur komisioni i rivlersimit konstaton se vizatimet e dorezuara nuk mund te identifikohen ne menyre te qarte fusha e tolerances per dimensionin **d1** , edhe ky konstatim i komisionit te rivlersimit **nuk qendron** , sepse vizatimet e prodhuesit te dorezuara ne oferte nga OE i rekomanduar kontrate **shihen shume qartë dhe janë të identifikueshme që fushat e tolerances janë H7** për të dy llojet e xhuntave hidrodinamike e që janë në kundërshtim me **kerkesen specifike** te kerkuar ne dosjen e tenderit.

(bashkangjitur dëshmin **nr.2** vizatimet e vertetuara nga vet prodhuesi ku **shihet qartë** që fushë e tolerancat për dimensionin janë **d1=H7** per dy tipet e xhuntave hidrodinamike)

Vizatimet e dorezuara te OE te rekomanduar per kontrate dhe vizatimi i publikuar dhe specifikimi teknik i detyrueshem Aneksi 1 në dosjen e tenderit shihen shumë qartë dhe jane të identifikueshme fushat e tolerances dimensionin per d1=m6

Fusha e Tolerances per dimensionin **d1=m6** është substanca e tenderit dhe baza kryesore e specifikimit teknik sepse eshte **kerkese specifike** me qene tolerance **d1=m6**

Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Nenin 59(Ekzaminimi , Vleresimi , dhe Krahassimi i Tenderëve dhe kjo perben plotesim dhe ndryshim material , devijim nga karakteristikat e parashtruara ne njoftimin per kontrate te ofertes teknike pas hapjes se tendereve.**

Pergjigje OE Ankues ne nr.2

Sa i perket tolerancave **H7** dhe **m6** i ka kemi dokumentuar më lartë OE , dhe po ashtu janë dhënë dallimet e ketyre tolerancave nga eksperti teknik në: **Raportin Ekspertit Shqyrtues nr. 2026/0233 dt.29.04.2026** , dhe AK nuk konsideron se ka te beje me ndryshimin e ofertes por vetem me konfirmim te perputheshmerise me kerkesat e dosjes se tenderit me sqarimin e tenderit edhe pse eshte ndryshuar baza teknike si **kerkese specifike** per tolerancen me qenë **d1=m6**

Dhe kjo per OE ankues perben ndryshim te ofertes teknike ose devijim material nga karakteristikat teknike pasë hapjes se tenderit.

Pergjigje OE Ankues ne nr.3

Ne vizatimin e prodhuesit të dorëzuar në oferten e dt.16.02.2026 për Xhunten hidrodinamike tipi Eg 320 dimensionet tjera sipas tab. 1.1 vizatimi i prodhuesi per dimensionin **ØB** ka dimensionin **220mm** , kurse sipas **Aneksit 1 Specifikimet teknike te detyrueshme** te dosjes se tenderit dimensionin **ØB** është këkuar me qenë : **226mm** dhe ky dimensione mund të vertetohet në dëshmin nr.2 ne vizatimin e prodhuesit per xhunten hidrodinamike Eg tip 320

Pergjigje OE Ankues ne nr.4

Lidhur me gabimin e OE te rekomanduar per kontrate ne pergjigjen e sqarimit te tenderit te dt.08.07.2026 ka perdorur per te dy llojet e xhuntave hidrodinamike emertimin e njejte: xhunta hidrodinamike tip **Eg 75**

Edhe OE ankues vetem e ka cekur se ka një gabim sepse ne DT(dosjen e tenderit) poz. 1 është xhunta hidrodinamike **tip Eg 750** kurse poz.2 xhunta hidrodinamike **tip Eg 320**

Pergjigje OE Ankues ne nr.5

AK ka theksuar se komisioni i rivlersimit ka vepruar ne menyre objektive dhe te pa anshme ne perputhje me kompetencat ligjore duke perdorur mekanizmin e sqarimit per te eliminuar paqartesisht ekzistueset, dhe AK nuk ka konstatuar se gjate zhvillimit te procedurave jane cenuar parimet themelore te ligjit per Prokurim Publik, duke theksuar se parashtruesi nuk ka paraqitur prova konkrete qe deshmojne se operatori ekonomik i rekomanduar ka ndryshuar oferten apo se AK ka vepruar ne kundershtim me dispozitat e LPP-se

Prova – dëshmia kryesore është qe komisioni i rivleresimit është thirrur që nuk mund të identifikohen qartë dimensionet e fushë tolerances për d1 dhe ka kerkuar sqarimin, duke kerkuar sqarimin se cilat fushe tolerancë do zbatohen gjate prodhimit te xhuntave **d1=m6** ose **d1=H7**

Ky konstatim i AK **nuk** qëndron sepse që nga dorëzimi i ofertes dt.16.02.2026, **fushë tolerancat për dimensionin d1 shihen shumë qartë dhe janë plotësisht të identifikueshme** si kerkese specifike nga AK, dhe si dëshmi Ankeses tonë i kemi bashkangjitur vizatimi i AK, Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme nga dosja e tenderit dhe vizatimet e prodhuesit te vertetuara nga vet prodhuesi.

Edhe pse fushe tolerancat per d1 shihen qartë dhe jane te identifikueshme komisioni i rivlersimit kerkon sqarimin e tenderit nga OE i rekomanduar per kontrate, duke bërë shkelje ligjore, sepse kjo per OE ankues përbën **ndryshim të ofertës teknike pas hapjes së tenderit gjë që ndalohet me LPP.**
(bashkangjitur dëshmia nr.1 dhe dëshmia nr.2)

Oferta e OE UNIVERS – M sh.p.k edhe me rastin e vlersimit nga komisioni vleresues dhe po ashtu me rastin e rivlersimit nga komisioni i rivleresimit oferta e jonë ka qenë e pergjegjshme e cila i ka plotesuar kerkesat dhe specifikat teknike te kerkuara ne dosjen e tenderit.

Ne pajtim me argumentet ligjore dhe faktike te dëshmuara me prova materiale nepermjet Kerkeses per Rishqyrtim (ju lutem, shih te bashkengjitur si pjese e perbashkete e kesaj Kerkese per rishqyrtim) te gjitha faktet gjegjesisht provat e prezentuara qe deshmojne qarte shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues.

Per cdo shoshitje/verifikim, vlerësim te argumenteve tona ligjore te prezentuara nepermjet fakteve te bashkengjitura, perfaqesuesit e Kompanise sone,jane te gatshem te ofrojne sqarime ligjore dhe teknike para Autoritetit Kontraktues ne fazen e shqyrtimit te Kerkeses per Rishqyrtim per te i mundesuar Autoritetit Kontraktues te konstatojone menyre te drejte, paaneshem, objektive dhe profesionale gjendjen faktike para marrjes se vendimit meritor.

PROPOZIM

Duke marre parasysh argumentet, faktet, provat e potencuara dhe arsyetimet e ofruara me arsyetim ligjor dhe pretendimet per shkeljet e dipozitave ligjore te specifikuar ne piken 7 te kesaj Ankese firma "Univers – M" sh.p.k i i propozon Panelit Shqyrtues në OSHP:

- te aprovoje Ankesen si te bazuar te OE "Univers – M" sh.p.k. dhe
- Lënden e kontestuar te ktheje ne RI – VLERËSIM të ofertave
- duke propozuar per dhenie te kontrates oferten e pergjegjshme me çmimin me te ulet e cila ploteson kerkesat, kriteret e dosjes se tenderit sipas rregullave të LPP-së

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë të konsiderueshme në fushen financiare rreth pregaditjes se dosjes tenderuese , garancioni i ofertes , vazhdimin e garancionit te ofertes , fitime te munguara, mos mundesi te kompenzimeve te ketyre shpenzimeve pergaditore, koston së përgaditjes së ankesave, stresit, shqetësimeve të shkaktuar, kontratës se humbur sipas rregullave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 01.Datë :23.01.2026 "Njoftimit për Kontratë"
- 02.Datë :16.02.2026 Procesverbali i hapjes
- 03.Datë :14.07.2026 Raporti i komisionit te Rivleresimit te tenderit
- 04.Datë:28.07.2026 Leter standarde per tenderuesin e pa suksesshem
- 05.Datë :28.07.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK – Dhenjen e kontrates publike
- 06.Datë:28.03.2026 Kerkese per qasje ne dokumente
- 07.Datë: 31.07.2026 Kerkesa per rishqyrtim ne AK
- 08.Datë :03.08.2026 Pergjigjja – Vendimi nga AK ne Kerkesen per rishqyrtim
- 09.Dëshmit – Argumentet nga nr.1 – 3
- 10.13.05.2026 Vendimi i OSHP-së nr.2026/0233
- 11.Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me neni118 te LPP

Verejtje:Te gjitha pretendimet tona tona mbeshketen ne fakte bashkangjitur ankeses , materialin e të gjithë tenderueseve e gjeni ne proceduren e prokurimit per kete aktivitet te prokurimit ne Autoritetin Kontraktues – Korporaten Energjetike te Kosoves sh.a.